



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 14 dhe 17, shkronja (c) dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm

Neni 1

Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publikë prona private e cekura si më poshtë;

- 1.1** Pjesa e parcelës kadastrale me **P-72116046-02978-0** sipas certifikatës së pronës Nr.500-2024 e datës 20.02.2024, me sipërfaqe të përgjithshme prej **6186m²** nga sipërfaqja e përgjithshme inters i përgjithshëm publik shpallen **144m²**, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Fshat” e evidentuar në emër të bashkëpronareve: 1. Agron (Hajrush) Berisha, 2. Malush (Beqir) Berisha, 3. Jakup (Muharrem) Berisha, 4. Sherif (Sejfulla) Berisha, 5. Mehdi (Muharrem) Berisha, 6. Ismet (Hasan) Berisha, 7. Skender (Sylejman) Berisha, 8. Tahir (Shaban) Berisha, 9. Enver (Sylejman) Berisha. 10 Hamdi (Avdi) Hoti që të gjithë nga Suhareka. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pronës të lartë cekura është **“Rregullimi infrastruktures në rrugën Mulla Nura dhe Gjergje Fishta” në qytetin e Suharekës.**

Neni 2

Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprimet të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në librin kadastral, do të jetë Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadaster dhe Drejtorin për urbanizë dhe planifikim në Komunën e Suharkës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI